

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

Ngjarjet në Shqipëri para formimit të BKTSH:

1. Viti rotarian 1990-1991:

- RC Alta Valle Esina Grotte di Frasassi ndërmerr nismën për themelimin e RC të parë në Shqipëri.
- Distrikti Rotarian 2090 mbështet nismën dhe fillon përpjekjet në bashkëpunim me një grup nismëtarësh të përzgjedhur prej grupit të punës së atij distrikti.
- RI ndërpret përkohësisht nismën, shkelje procedurash, duhej më parë që RI të miratonte Çeljen e Shqipërisë për Rotary-n.
- D2090RI kryen formalitetet e kërkuara nga RI
- RI miraton Çeljen e Shqipërisë për Rotary-n.
- 15 qershor 1991, mbledhja e parë përgatitore e RC Tirana (klub provizor). Emrohet Këshilli Drejtues provizor.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

2. Viti Rotarian 1991-1992:

- RI miraton statusin PEA për klubet e ardhëshme Rotary në Shqipëri
- RI ngarkon Governorët e rradhës të D 2090RI në rolin e Përfaqësuesit Special për Themelimin e RC Tirana dhe më tej në rolin e Përfaqësuesit Special për drejtimin e Rotary-t në Zonën PEA të Shqipërisë.
- Vazhdojnë procedurat për themelimin e RC Tirana.
- RIP Rajendra Saboo më 9 mars 1992 firmos Kartën e Themelimit të RC Tirana.
- Karta e Themelimit dorëzohet prej tij personalisht në Tiranë më 11 maj 1992 në prani të rreth 500 rotarianëve të ardhur kryesisht nga Italia.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

3. Viti rotarian 1999-2000:

- Nëntor 1999: RI organizon një mbledhje me drejtuesit e Rotary-t në zonat PEA dhe SEA të Evropës Lindore dhe Juglindore. Shqipëria përfaqësohet nga Guv. Alberto Breccia Frattadocchi. Propozohet që Rotary i Shqipërisë të përfshihet në D 2090RI.
- Nëntor-dhjetor 1999: Guv. Frattadocchi thërret Asamblenë e RC Tirana. Asambleja njëzëri miraton përfshirjen në D2090RI.
- Janar 2000: Asambleja e Jashtëzakonëshme e D2090RI shqyrton kërkesën e RC Tirana dhe kërkesën e klubeve Rotary të Federatës së Serbisë e Malit të Zi për përfshirjen në D 2090RI. Miratohet njëzëri pranimi i RC Tirana. Me shumicë votash hidhet poshtë kërkesa tjetër. RC Tirana shpjegon qendrimin e vet ndaj kërkesës së dytë.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

4. Viti Rotarian 2000-2001:

- Guv. Giorgio Miletta dhe RC Tirana firmosin marrëveshjen për rritjen graduale të kuotave të RC Tirana për buxhetin e D2090RI. Fillohet me 40 Euro/rotarian/vit, rritja 10% e kësaj shume për çdo vit rotarian.
- Guv. Giorgio Miletta çel procedurat për themelimin e RC Durrës.
- Paraprakisht RC Tirana kishte pranuar rreth 10 rotarianë banorë të Durrësit, që frekuentuan klubin rregullisht për 1-2 vite rotariane.
- Themelohet RC Durrës.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

5. Viti rotarian 2001-2002:

- Niko Nosi, Antar i Komisionit të D2090RI për Zgjerimin e Rotary-t, (Nënkom. për Shqipërinë), bashkë me Ilija Ninka-n, njoftojnë D2090RI se kanë filluar procedurat për themelimin e RC Korça.
- Kryetari i Komisionit, PDG Giorgio Rossi, urdhëron ndërprerjen e kësaj nisme, për shkak të shkeljes së procedurave.
- RC Tirana rifillon përçapjet në përputhje me procedurat.
- D 2090 RI nuk përgjigjet.
- RC Tirana dërgon Presidentin E.Karaxho në Budapest, ku ai takon RIP Richard King. Shpjegohet ngërçi. RIP urdhëron D2090 RI që të fillojë procedurat. Me propozim të N.Nosi, D2090 RI emëron I. Ninkan si Përfaqësues Special.
- Themelohet RC Korça, ceremonia në Tiranë në prani të RIP R. King.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

6. Viti Rotarian 2003-2004:

- Niko Nosi, Antar i Komisionit të D2090RI për Ruajtjen dhe Zgjerimin e Rotary-t, (Nënkom. për Shqipërinë), prashtron shkresërisht në komision studimin mbi nevojën dhe mundësitë e shtimit të numrit të klubeve Rotary në Shqipëri.
- Komisioni nuk mblidhet dhe kërkesa nuk shqyrtohet.
- Përgjigja gojore merret në rrugë të tërthorta: Këshilli i Past Governatorëve ka vendosur se duhet një periudhë disavjeçare për konsolidimin e dy klubeve të rinj (Durrësi, Korça).

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

7. Viti Rotarian 2007-2008:

- Në takimin e K.D të RC Tirana me Guv. Massimo Massi Benedetti, Niko Nosi shtron me forcë çështjen e shtimit të numrit të klubeve në Shqipëri.
- Massi Benedetti ngarkon Asistentin e tij për Shqipërinë Shpëtim Leka për të dërguar argumentimin e plotë të kërkesës.
- Kërkesa përpilohet së bashku me N.Nosin. Argumenti kryesor ishte pamundësia e RC Tirana për të mbuluar një territor shumë të gjerë. Argumenti tjetër ishte raporti i ulët rotarian/banor.
- Këshilli i Past Guvernatorëve miraton çeljen e procedurave për themelimin e klubeve të rinj në territorin e RC Tirana, por vetëm jashtë qytetit të Tiranës.
- Miratimi hynte në fuqi duke filluar nga viti rotarian i ardhshëm.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

8. Viti Rotarian 2008-2009:

- Guv. Giorgio Splendiani miraton në parim çeljen e procedurave për themelimin e tre klubeve të rinj, në Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.
- RC Tirana ngre komisionet për tre klubet e rinj, por vetëm komisioni i themelimit të RC Elbasan përparon mjaftueshëm në zbatimin e detyrës së tij.
- Guv. Splendiani emron Ilir Qerfozin si Përfaqësues Special për Themelimin e RC Elbasan.
- Në qershor 2009 zhvillohet në Elbasan ceremonia e themelimit të RC Elbasan.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

9a. Viti Rotarian 2010-2011:

- Në ditët e fundit të vitit rotarian, RI njoftoi se ishte vendosur shkëputja e klubeve Rotary të Shqipërisë nga D 2090 RI, me status ende të papërcaktuar.
- Klubet Rotary të D 2009RI kishin një kohë të caktuar për kundërshtimin e këtij vendimi. RC Alta Valle Esina Grotte di Frasassi ndërmori një nismë për brenda distriktit për paraqitjen e kundërshtimeve, por nuk pati mbështetje të mhaftueshme.

9b. Viti Rotarian 2011-2012:

- Dr. Anton Hilscher emrohet përfaqësues Special i RIP për klubet Rotary të Shqipërisë.
- RI vendos që klubet Rotary të Shqipërisë të grupohen në Zonën 0055

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

Ngjarjet në Kosovë para përfshirjes së saj në Z. 0053:

- Në fillim të vitit 2000 klubet Rotary të Greqisë së Veriut u shkëputën nga Distrikti Rotary i Greqisë dhe u formua D2480RI. Klubet Rotary të Bullgarisë, Federatës Serbi e Mali i Zi, Maqedonisë, që ishin në zona të padistriktuara, u përfshinë në D2480RI. Për Kosovën nuk ishte marrë asnjë vendim.
- Përpjekjet për themelimin e klubeve të rinj filluan në Kosovë menjëherë pas kthimit të refugjatëve nga Shqipëria. Rrugëtimi ishte i gjatë dhe i vështirë për shkak të situatës së kontestueshme të statusit të shtetit të porsalindur të Kosovës. RC Tirana ka qenë shumë aktive në atë kohë.
- RI në vitin 2005 përfshiu “Territorin e Kosovës, nën administrimin e UNMIK-ut”, në D 2480 RI dhe çeli procedurat e themelimit të klubeve të rinj në Kosovë.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

- Vazhdoi shtimi i numrit të klubeve në të gjitha pjesët e D2480RI.
- RI vendosi ndarjen e D 2480 RI në dy distrikte:
 - a. D2481RI: klubet e Greqisë së Veriut, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës.
 - b. D2482RI: klubet e Bullgarisë. Parvjet atje ishin 85 klube, 2317 antarë.
- Më 18.2.2009 RI vendosi ndarjen e D2481RI, me efekt nga 1.7.2011, në dy distrikte :
 - a. D2483RI: Klubet Rotary të Serbisë dhe të Malit të Zi. Parvjet atje ishin 62 klube me 1467 antarë.
 - b. D2484RI: Klubet e Greqisë së Veriut: Parvjet ishin 42 klube me 954 antarë.
 - c. Zona e Padistriktuar 0053 (Kosova).
 - d. Zona e Padistriktuar 0054 (Maqedonia).

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Gjatë periudhës së miratimit ose jo të vendimit të RI për coptimin e D2481RI, klubet Rotary të Kosovës patën shumë komunikime midis tyre dhe arritën në një qendrim të përbashkët për shprehjen parapëlqimit për distriktimin e ardhshëm të tyre.
- U kërkua bashkëpunimi me RC të Shqipërisë. RC Tirana, në emër të klubeve të tjerë, garantoj se do të mbështej një kërkesë e mundëshme e RC të Kosovës për hyrjen e tyre në D2090RI.
- Asambleja e Jashtëzakonëshme e klubeve Rotary të Kosovës miratoi vendimin që t'i kërkohej RI-së përfshirja e tyre në të njëjtin distrikt si edhe klubet e Shqipërisë, dmth në D2090RI.
- Në emër të rotarianëve të Kosovës, Neshad Asllani dërgoi kërkesën formale në RI, D2481RI dhe D2090RI.
- RC Tirana, brenda rregullave, i shprehu RI-së dhe D2090RI-së parapëlqimin për pranimin e klubeve kosovare në D2090RI.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

- RI nuk e miratoi kërkesën e klubeve kosovare. Në pamundësi për një ridistriktim të tyre të menjëhershëm, RI vendosi përfshirjen e tyre në një zonë të padistriktuar të emërtuar Z.0053.

Ridistriktimi i klubeve Rotary të Maqedonisë:

- Pas vendimit të Ri për shkëputjen e tyre nga D2481RI, klubet maqedonase u vunë përpara detyrës së gjetjes së mundësitsë së ridistriktimit të ardhëshëm.
- Shoqata e Klubeve Rotary të Maqedonisë, që ishte themeluar dhe funksiononte brenda D2481RI edhe më parë, thirri një Asamble të Jashtëzakonëshme e cila vendosi “baraslargësinë nga rotary i shteteve fqinje”, pa mundur të gjejë zgjidhje tjetër.
- RI vendosi t'i lërë klubet maqedonase në një zonë të padistriktuar më vehte, të emërtuar Z.0054.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

Zhvillimet e mëtejshme në Zonat e Padistriktuara Z 0053, Z 0054, Z 0055:

Viti 2010-2011:

- RIP emroi Dr. Anton Hilscher si Përfaqësues Special për klubet Rotary të Z. 0053 dhe Z.0054 (Kosovë, Maqedoni).
- Fillimisht bashkëpunimi i tij ishte i veçantë me secilën zonë të Rotary-t.
- Në vijim, ai thirri në Ohër një mbledhje këshilluese me tre rotarianë të zgjedhur prej tij nga secili shtet. U vendos themelimi i një bordi këshillimor, modalitetet e të cilit do të përcaktoheshin më vonë.
- Dr.A.Hilscher vizitoi selinë e RI në Evaston dhe sqaroi një sërë çështjesh lidhur me kompetencat e tija dhe të bordit këshillimor të ideuar prej tij.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

Viti 2011-2012:

- RIP emroi Dr. Anton Hilscher si Përfaqësues Special edhe për klubet Rotary të Z. 0055 (Shqipëria).
- Në fund të Gushtit 2011, bazuar në rekomandimet e drejtuesve të Rotary-të Kosovës, ai thirri tre rotarianë nga Shqipëria në mbledhjen e Bordit Këshillimor. Niko Nosi, Gjergji Çiço dhe Pandi Papando u paraqitën në atë mbledhje duke deklaruar se nuk e kishin mandatin e klubeve Rotary të Shqipërisë.
- Mbledhja u zhvillua në nivelin e shprehjes së opinionëve. Kosovarët dhe maqedonasit aritën të marrin nga Dr.A.Hilscher miratimin që tre këshilltarët e bordit që ai do të emronte nga secili shtet të propozoheshin nga strukturat drejtuese të Rotary-t të shtetit përkatës.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Pjesëmarrësit nga Shqipëria përcollën në klubet Rotary kërkesën e Dr.A.Hilscher për të propozuar tre kandidatura për përfaqësimin e Shqipërisë. Në mungesë të strukturave drejtuese të Rotary-t në Shqipëri, nismën e mori Presidenti i RC Tirana, Fatos Çuçi, i cili komunikoi me presidentët e tre klubeve të tjerë.
- Klubet propozuan Niko Nosin, Gjergji Çiçon dhe Vasil Martopullon.
- Në emër të katër klubeve, Fatos Çuçi njoftoi Dr.A.Hilscher.
- Dr.A.Hilscher ja paraqiti këto kandidatura RIP Banerjee, i cili i miratoi ato si këshilltarë nga Shqipëria të Bordit Këshillimor Treshtetësh.
- RI nuk ka caktuar asnjë fond për udhëtime e dieta për antarët e BKTSH. Orientimi i Dr.A.Hilscher është që shpenzimet e tyre të përballohen ose nga strukturat drejtuese të Rotary-t të shteteve përkatëse, ose nga klubet që i kanë propozuar. Në rastin e Shqipërisë, shpenzimet përballohen pjesërisht nga klubet propozuese dhe pjesërisht nga vetë këshilltarët.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Mbledhjet e mëtejshme të Bordit u përqëndruan në mënyrën më të mirë të funksionimit të organeve drejtuese të Rotary-t në secilin shtet, në funksion të detyrave që Dr.Hilscher ka marrë nga RIP.
- Vendimet e Bordit janë këshilluese. Deri tani ato janë marrë njëzëri. Dr.A.Hilscher ruan të drejtën të vendosë vetë, sipas kompetencave që ka marrë nga RIP.
- Sugjerimet e Dr.A.Hilscher për disa ndryshime të Rregullores së Këshillit të Klubeve Rotary të Kosovës u muarrën parasysht prej tyre dhe tani marrëdhëniet midis klubeve atje ndërtohen në një mënyrë pak të ndryshme nga ajo e kohës kur ishin pjesë e D2481RI.
- Eksperienca e klubeve në Kosovë e Maqedoni, që patën vetvepruar në një masë të madhe si pjesë të D2481RI, me emërtesën formale “Nëndistrikt”, si edhe orientimet e detajuara të Dr.A.Hilscher, kanë vlejtur shumë edhe për klubet Rotary të Shqipërisë.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Vendi i mbledhjes ndryshon me rotacion. Klubi mikpritës përballon shpenzimet e sallës, bufesë e drekës. Presidenti i atij klubi ftohet në mbledhje me të drejtë fjale.
- Këshilltarët Shqiptarë në BKTSH kanë marrë pjesë deri tani në 12 mbledhje.
- Tre mbledhje të BKTSH janë mikpritur deri tani nga tre klubet përkatës të këshilltarëve shqiptarë.
- Afati i qendrimit të këshilltarëve në postet përkatëse, rizgjedhja e tyre ose jo, nuk janë përcaktuar ende nga organet drejtuese të RI.
- Modalitetet e zgjedhjes së këshilltarëve në të ardhmen janë përcaktuar nga RI në vija të përgjithëshme. Ata do të propozohen nga strukturat drejtuese të Rotary-t në secilin shtet. Nuk dihet ende kualifikimi minimal rotarian që duhet të kenë të propozuarit nga Shqipëria në të ardhmen.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Me orientim të vazhdushëm të Dr.A.Hilscher, bazuar në vendimet këshilluese të BKTSH, në vitin rotarian 2011-2012 filloi puna për ngritjen e strukturës drejtuese të klubeve Rotary në Shqipëri.
- Nisma u muarr nga RC Tirana, si klubi më i vjetër. E njëjta gjë kishte ndodhur më parë edhe në Maqedoni e Kosovë. Nën kujdesin e presidentit të RC Tirana dhe në bashkëpunim me tre këshilltarët, u organizua në Tiranë, më 30 janar 2012 mbledhja themeluese, në të cilën ndër të tjera u vendos:
 - a. Themelimi i Bordit Provizor të Klubeve Rotary të Shqipërisë.
 - b. Përbërja e Bordit,
 - c. Parimi i rotacionit, në funksion të autonomisë së klubeve,
 - d. Hartimi i rregullores,
 - e. Përfaqësimi i klubeve në strukturat drejtuese të RI,
 - f. Organizimi i seminareve kualifikuese, etj.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- Nën drejtimin e BPKRSH u përgatitën 6 drafte të një vendimi që do të merrej për krijimin e Bordit të Klubeve Rotary të Shqipërisë (BKRSH), në një mbledhje të ardhëshme.
- Një nga detyrat që morri përsipër BPKRSH, ndonëse ende “provizor”, ishte edhe marrja e miratimit nga Dr.A.Hilscher për fillimin e procedurave për themelimin e RC Tirana West.
- Më 21 prill 2012 u organizua nga RC Elbasan, si klub mikpritës, mbledhja e BPKRSH.
- Vendimi nr. 2 i BPKSH përmban:
 - a. Themelimin e Bordit të Klubeve Rotariane të Shqipërisë (BKRSH), i cili hyn në fuqi duke filluar nga data 1 korrik 2012.
 - b. Emrimin e antarëve e grupit të punës për hartimin e Rregullores së Bordit.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- d. Parimin e përbërjes së bordit,
- e. Parimet e rotacionit,
- f. Pranimin e klubeve të rinj automatikisht në Bord,
- g. Hyrjen në rradhën e drejtimit të bordit të klubeve të rinj nga Past Presidenti i tretë i tyre.
- h. Parimet e bashkërendimit të punës në Bord,
- i. Respektimin e autonomisë së klubeve për çështjet që janë në kompetencë të tyre.
- j. Përfaqësimin e klubeve në strukturat drejtuese të RI e më gjerë, për çështjet që janë në interes të përbashkët.
- k. Organizimin e seminareve trajnuese.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Informacion nga N.Nosi

- l. Koordinimin e emrimit të antarëve me pozita të larta drejtuese në distrikt dhe më tej, bazuar në kandidatët e propozuar nga klubet rotariane të Shqipërisë.
- m. Krijimin dhe drejtimin e punës së Komisioneve Ndërshtetërore të Bashkëpunimit Rotarian.
- n. Ushtrimin të rolit të arbitrit në raste të kundërshtisë midis dy ose më shumë klubeve.
- o. Emrimin e komisioneve të posaçme për koordinimin e aktiviteteve të parashikuara në detyrat e veta, sa herë që do ta shikojë të nevojëshme.
- p. Bashkërendimin e punës së klubeve rotariane për krijimin e klubeve të reja në Shqipëri, duke respektuar të drejtën e vendim-marrjes së çdo klubi brenda juridiksionit të ushtrimit të veprimtarisë së vet.

Bordi Këshillimor Treshtetësh Shqipëri, Maqedoni, Kosovë
Informacion nga N.Nosi

- p. Miratimin e Listës së Klasifikimeve Rotariane, e zbatueshme nga klubet rotariane të Shqipërisë.
 - q. Duke filluar që nga viti rotarian 2012-2013, Bordi do të ketë buxhetin e tij. Ky buxhet do të bazohet në të ardhurat dhe shpenzimet:
 - + 12 euro/antar/vit për projekte mbarështetërore në dobi të komunitetit,
 - + 12 euro/antar/vit për shpenzime administrative apo të përfaqësimit të përbashkëta të klubeve,
 - + 12 euro/antar/vit për kontribut të bashkërenduar në favor të TRF.
- Në Rregulloren e Bordit do të përcaktohet në mënyrë të detajuar administrimi, kontrolli e raportimi i buxhetit të Bordit.

Zhvillimet e fundit

1.

